



UNIONI I BASHKIVE SHQIPTARE NE RAJON

KËRKESE PER OFERTE

“Për kontraktimin e një Designeri/Kuratori artistik që do të realizojë idenë dhe konceptin për zhvillimin e Pritjes Zyrtare për hapjen e sezonit turistik dhe Mbledhjes së Asamblesë dhe Forumit Ekonomik të datës 10.06.2021 organizuar nga UBSHR”

UNIONI I BASHKIVE SHQIPTARE NË RAJON, në zbatim të fazës së dytë të projektit të Turizmit Rajonal, kërkon të rekrutojë 1 (një) konsulent të jashtëm të kualifikuar në grafik dizajn të eventeve si dhe në kurimin e detajeve të eventit. Në datë 10.06.2021, UBSHR do të organizojë një pritje zyrtare me të ftuar nga Rajoni, ku do hapet sezoni turistik në të gjitha qytetet anëtare. Për këtë event kërkohet ekspertiza e Kuratorit/Designerit me detyrat si me poshtë.

Detyrat

- Kuratori do jetë përgjegjës për kompozimin e eventit, përcaktimin e konceptit mbi të cilën do të realizohet dizajni dhe interiori i hapësirës.
- Kuratori dhe dizajneri duhet të bashkëpunojnë me stafin e UBSHR, për të hartuar konceptin e mbrëmjes sic kërkohet nga shoqata.
- Dizajneri do marrë përsipër dizejnimin e ftesave për pjesëmarrësit dhe dizejnimin e bannerit.
- Dizejnimi i agjendës së Mbledhjes së Asamblesë dhe Forumit Ekonomik.
- Krijimi/përzgjedhja e një simboli përfaqësues të traditës së qyteteve tona, e cila do realizohet më pas në një punim me dorë.

Periudha e zbatimit të detyrave

Data e fillimit të zbatimit do të jetë nga nënshkrimi i kontratës nga të dyja palët.

Kriteret për përzgjedhjen

1. Eksperienca në treg
2. Kostoja më e ulët e shërbimit

Dokumentacioni që duhet të dorëzohet

1. CV profesionale
2. Ekstrakt QKB
3. Oferta financiare

Afati kohor për dorëzimin e ofertave: 31.05.2021 ora 11:00.

Cdo person i interesuar mund të dërgojë dokumentat mbi këtë procedurë përmes komunikimit elektronik në adresën email ubshr@tirana.al, ose duke u paraqitur pranë zyrave të Unionit në adresën *Sheshi Skënderbeu, Pallati i Kulturës, Kati 2, Zyra 18.*

DREJTORI EKZEKUTIV

Andriola Kambo

